REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL, BUJQËSISË, MBROJTES CIVILE
SEKTORI I MBROJTJES DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. _____ Prot. Durrës, më ___/___/2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTEVE: "VLERËSIMI I RISKUT NGA FATKEQËSITË NATYRORE – BASHKIA DURRËS", "PLANI VENDOR PËR EMERGJENCAT CIVILE – BASHKIA DURRËS" DHE "STRATEGJIA VENDORE PËR ZVOGËLIMIN E RISKUT NGA FATKEQËSITË – BASHKIA DURRËS"

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, veçanërisht nenit 3, "Misioni i vetëqeverisjes vendore", nenit 9, "Të drejtat dhe përgjegjësitë", nenit 29, "Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike" dhe nenit 54, "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak"; si dhe të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019, "Për Mbrojtjen Civile", veçanërisht nenit 9, pika 5, "Vlerësimi i riskut", nenit 11, "Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë", nenit 12, "Harmonizimi i planeve të zhvillimit urban me strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë", nenit 14, pikat 6 dhe 7, "Planet për emergjencat civile", nenit 30, shkronjat "a", "c" dhe "ç", si dhe nenit 72, pika 4, paraqesim për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Durrës dokumentet e mëposhtme:

1. "Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore – Bashkia Durrës";
2. "Plani Vendor për Emergjencat Civile – Bashkia Durrës";
3. "Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë – Bashkia Durrës".

Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, pronës, infrastrukturës, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të territorit nga pasojat e fatkeqësive përbën një nga përgjegjësitë e rëndësishme të institucioneve të vetëqeverisjes vendore. Në këtë kuadër, Bashkia Durrës ka përgjegjësinë të ndërmarrë masa konkrete për identifikimin, vlerësimin, parandalimin dhe zvogëlimin e riskut, si dhe për organizimin dhe koordinimin e strukturave përgjegjëse në përgatitjen dhe përballimin e situatave emergjente.

Territori i Bashkisë Durrës, për shkak të karakteristikave të tij gjeografike, gjeologjike, hidrologjike, demografike dhe ekonomike, është i ekspozuar ndaj një sërë rreziqesh natyrore, të cilat mund të shkaktojnë pasoja në jetën dhe sigurinë e komunitetit, banesa, infrastrukturë, tokë bujqësore, aktivitete ekonomike dhe mjedis. Ndër rreziqet kryesore evidentohen përmbytjet, rrëshqitjet e tokës, erozioni, tërmetet, zjarret dhe fenomenet e motit ekstrem. Këto rreziqe kërkojnë

vlerësim të vazhdueshëm, identifikim të zonave më të ekspozuara dhe planifikim të masave parandaluese e mbrojtëse.

Përvoja e krijuar nga situatat e ndryshme emergjente të evidentuara në territorin e Bashkisë Durrës ka nxjerrë në pah nevojën për një qasje të integruar dhe të mirëstrukturuar në drejtim të parandalimit, përgatitjes, zvogëlimit të riskut dhe menaxhimit të pasojave të fatkeqësive. Në këtë drejtim, hartimi i dokumenteve strategjike dhe planifikuese përbën një instrument të domosdoshëm për identifikimin e problematikave, përcaktimin e prioriteteve të ndërhyrjes dhe forcimin e kapaciteteve institucionale dhe komunitare për përballimin e situatave të ndryshme të rrezikut.

Në kuadër të forcimit të qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe të sistemit të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror dhe vendor, në Shqipëri zbatohet Programi ALBAdapt, "Programi për një Zhvillim Urban Rezistent ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri", nga Organizata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), me mbështetjen e Fondit të Gjelbër për Klimën (GCF) dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC).

Në kuadër të këtij programi, për Bashkitë Durrës, Shijak dhe Krujë, si dhe për Prefekturën e Qarkut Durrës, u realizua projekti "Hartimi i Vlerësimeve të Riskut nga Fatkeqësitë, i Strategjive Vendore për Zvogëlimin e Riskut dhe i Planeve Vendore të Emergjencave Civile", i zbatuar nga konsorciumi Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, dhe MetroPOLIS Shpk, nën koordinimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Hartimi i dokumenteve për Bashkinë Durrës është zhvilluar në bashkëpunim me strukturat përkatëse të bashkisë, nëpërmjet një procesi teknik dhe institucional, i cili ka përfshirë mbledhjen dhe analizimin e informacionit, vlerësimin e kapaciteteve ekzistuese dhe përgatitjen e dokumenteve përkatëse.

Në mënyrë të veçantë, hartimi i dokumentit "Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore – Bashkia Durrës" është realizuar përmes një procesi të strukturuar konsultimi, bashkëpunimi dhe validimi teknik. Ky proces ka përfshirë plotësimin e pyetësorit për vlerësimin e kapaciteteve të mbrojtjes civile gjatë muajit mars 2026; validimin e parë të përbashkët të hartave të riskut dhe të vetëvlerësimit të kapaciteteve, më datë 30.03.2026; validimin e dytë të draftit të Vlerësimit të Riskut, më datë 19.06.2026, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bashkive, Prefekturës së Qarkut Durrës, AKMC-së dhe GIZ-it; si dhe rishikimin përfundimtar të dokumentit gjatë muajit nëntor 2026.

Metodologjia e përdorur në hartimin e Vlerësimit të Riskut është e harmonizuar në nivel qarku dhe kombëtar, duke përdorur të njëjtën formulë dhe shkallë të indeksit të riskut me vlerësimet e realizuara për Bashkitë Shijak dhe Krujë, në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të riskut në nivel qendror. Kjo mundëson krahasueshmërinë dhe koherencën e rezultateve, si dhe krijon një bazë të përbashkët për planifikimin e masave dhe ndërhyrjeve për zvogëlimin e riskut në territorin e qarkut.

Në këtë kuadër, dokumenti "Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore – Bashkia Durrës" përbën bazën teknike dhe analitike për identifikimin dhe analizimin e rreziqeve natyrore që mund të prekin

territorin e bashkisë, duke marrë në konsideratë ekspozimin e popullsisë, cenueshmërinë e komuniteteve, infrastrukturës dhe aseteve ekonomike, si dhe kapacitetet ekzistuese për përballimin e situatave të emergjencës. Nëpërmjet këtij dokumenti evidentohen zonat më të ekspozuara ndaj rreziqeve dhe analizohen pasojat e mundshme të fatkeqësive, duke krijuar një bazë të rëndësishme për përcaktimin e prioriteteve të ndërhyrjeve parandaluese, orientimin e investimeve publike dhe përfshirjen e konsideratave të riskut në proceset e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Në vijim të rezultateve të Vlerësimit të Riskut, dokumenti "Plani Vendor për Emergjencat Civile – Bashkia Durrës" përcakton organizimin dhe mënyrën e funksionimit të strukturave përgjegjëse për përgatitjen dhe përballimin e situatave emergjente. Nëpërmjet tij përcaktohen përgjegjësitë institucionale, mekanizmat e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, procedurat e njoftimit dhe paralajmërimit, masat për evakuimin dhe asistencën ndaj komunitetit, si dhe organizimi dhe përdorimi i kapaciteteve njerëzore, materiale dhe logjistike në dispozicion. Ky dokument synon të garantojë një reagim të organizuar dhe të koordinuar në rastet e emergjencave civile, me qëllim mbrojtjen e jetës së qytetarëve, kufizimin e dëmeve dhe menaxhimin sa më efektiv të pasojave të fatkeqësive.

Ndërkohë, dokumenti "Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë – Bashkia Durrës" përcakton drejtimet strategjike, objektivat dhe prioritetet e bashkisë për parandalimin dhe zvogëlimin e riskut në një perspektivë afatmesme dhe afatgjatë. Strategjia synon integrimin e masave për reduktimin e riskut në politikat dhe programet vendore, në planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe në proceset e planifikimit të investimeve publike. Nëpërmjet saj synohet forcimi i kapaciteteve institucionale, përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet strukturave përgjegjëse, rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së komunitetit, si dhe nxitja e ndërhyrjeve që kontribuojnë në mbrojtjen e popullsisë, pronës, infrastrukturës dhe mjedisit.

Tre dokumentet e paraqitura për miratim janë të ndërlidhura dhe plotësojnë njëri-tjetrin në funksion të krijimit të një sistemi vendor të integruar të menaxhimit të riskut dhe mbrojtjes civile. Vlerësimi i Riskut evidenton dhe analizon rreziqet dhe cenueshmërinë e territorit; Strategjia Vendore përcakton objektivat dhe masat për zvogëlimin e tyre në një perspektivë afatgjatë; ndërsa Plani Vendor për Emergjencat Civile përcakton organizimin dhe veprimet konkrete për përgatitjen dhe përballimin e situatave emergjente.

Miratimi i këtyre dokumenteve do t'i mundësojë Bashkisë Durrës të ketë një kuadër të unifikuar referimi për planifikimin dhe zbatimin e masave në fushën e mbrojtjes civile, duke kontribuar në përmirësimin e vendimmarrjes vendore, përcaktimin e ndërhyrjeve prioritare, orientimin e investimeve drejt zonave me risk të evidentuar, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rritjen e kapaciteteve për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive.

Për sa më sipër, duke vlerësuar rëndësinë e këtyre dokumenteve për përmbushjen e detyrimeve ligjore të Bashkisë Durrës në fushën e mbrojtjes civile, si dhe për garantimin e sigurisë së komunitetit dhe mbrojtjen e territorit nga pasojat e fatkeqësive, propozojmë shqyrtimin dhe miratimin nga Këshilli Bashkiak Durrës të dokumenteve:

1. "Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore – Bashkia Durrës";
2. "Plani Vendor për Emergjencat Civile – Bashkia Durrës";

3. “Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë – Bashkia Durrës”.

Konceptoi:
Miratoi: O.Marku.